



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe në Rregulloren së Komunës së Gjiçanit për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve Nr.016-126422, dt.29.12.2016, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-Gjiçan shpall:

Udhëzimet për Aplikantët

Prill, 2022

Përmbajtja

1. Hyrje	2
2. Si të aplikoni	2
2.1 Dokumentacioni i detyrueshëm për OJQ	2
2.2 Dokumentacioni i detyrueshëm për Individë	3
2.3 Ku ta dorëzoni aplikacionin	4
2.4 Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve	4
3. Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi.....	4
4. Kalendarit tregues.....	5

1. Hyrje

Rregullorja për Kriteret Standardet dhe Procedurat e financimit publik për OJQ-të në Nenin 14 ka paraparë edhe përgatitjen e udhëzimeve të thirrjes për Aplikantët për paraqitjen e informacionit mbi objektivat e thirrjes publike, kushtet e thirrjes, mënyrën e aplikimit dhe zbatimit të procedurës së thirrjes dhe përzgjedhjes së përfituesve. Udhëzimet për aplikuesit kanë për qëllim të japin një pasqyrë të plotë të qëllimit të hapjes së thirrjes publike. Aplikuesi duhet të analizojë në mënyrë të plotë thirrjen publike dhe këtë udhëzim për aplikim për të krijuar një pasqyrë mbi qëllimin e ofruesit të mbështetjes financiare me rastin e hapjes së thirrjes publike.

Sa i përket procesit të pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënies së fondeve, kohës dhe mënyrës së parashtrimit të ankesave, trajtimit të dokumenteve dhe kalendarit tregues të zbatimit të thirrjes, lexoni udhëzimet këtu: [Rregullore MF – Nr. - 04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik te OJQ-ve](#)

2. Si të aplikoni?

Aplikimi i OJQ-ve dhe Individëve konsiderohet i plotë, nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në paragrafin 2.1 përkatësisht 2.2 dhe dorëzohen siç kërkohet në paragrafin 2.3 nga ky udhëzim.

2.1 Dokumentacioni i detyrueshëm për OJQ

1. Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së;
2. Çertifikata e Nr. Fiskal të OJQ-së;
3. Vërtetimi/ konfirmimi bankar i OJQ-së;
4. Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të OJQ-së;
5. Aplikacioni për projekt;
6. Forma e buxhetit;

7. Deklarata mbi financimin e dyfishtë për OJQ;
8. Deklarata e partneritetit për OJQ;
9. Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin paraprak;

2.2 Dokumentacioni i detyrueshëm për Individë

1. Aplikacioni për projekt;
2. Kopja e letërnjoftimit;
3. Certifikatë e vendbanimit;
4. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
5. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
6. Forma e buxhetit;

Shkarko, dhe plotëso me kompjuter, dokumentacionin (Aplikacioni për projekt, forma e buxhetit, deklarata mbi financimin e dyfishtë, deklarata e partneritetit, deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin paraparak) të cilat janë publikuar në kuadër të kësaj thirrje.

2.3 Ku ta dorëzoni dokumentacionin:

- Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Për individët, kërkohet vetëm nënshkrimi.
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në kopje fizike, në adresën e mëposhtme:
- Aplikimi origjinal, duhet të dorëzohet në Qendrën për shërbim me qytetarë, ndërtesa e Soliterit, kati I. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i plotë i aplikuesit me shënimin: “Të mos hapet para takimit të Komisionit Vlerësues”.

2.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga data: 08.04.2022 deri më 29.04.2022.

2. Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni, DKRS-ja do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, kanë hyrë në listën e përkohshme të projekteve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, DKRS-ja do të kërkojë shqyrtimin e vijave buxhetore për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara. Linjat buxhetore duhet të nënshkruhen nga përfituesi i projektit dhe zyrtari përgjegjës në DKRS.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar, përfituesi do të refuzohet.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për financimin e projekteve.

3. Kalendari tregues

Fazat e procedurës së thirrjes:

- Afati i fundit për aplikimet : 29.04.2022, në ora 16:00.
- Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen : 25.04.2022 në ora 16:00.
- Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen : 25.04.2022, në ora 16:00.
- Afati i fundit për vlerësimin e aplikimeve në mënyrë përmbajtjesore: 20.05.2022, në ora 16:00.
- Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë: 22.05.2022, në ora 16:00.
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar: 15.05.2022, në ora 16:00.
- Afati i fundit për dorëzimin e ankesave: 27.05.2022, në ora 16:00.
- Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi aplikantëve: 07.06.2022, në ora 16:00.